

PERIODICALS

FROM FEBRUARY 2
TO FEBRUARY 4
2010, VOLUME 18
NO. 1920
\$1.50

COPYRIGHT © 2010
ILLYRIA
THE ONLY ALBANIAN -
AMERICAN NEWSPAPER, INC.

Published in New York

THE ONLY ALBANIAN - AMERICAN NEWSPAPER

ILLYRIA

Triumfi i Bashkim Paçukut shpërblehet gjatë një koncerti në Carnegie Hall

Tenori shquar shqiptar fitoi Çmimin e Parë në Konkursin Ndërkombëtar të Vokalit Barry Alexander



Bashkim Paçuku në skenën e Carnegie Hall duke interpretuar "E lucevan le stelle" nga opera "Tosca". Në piano, Anna Shelest. (Foto nga Stefan Cohen)

faqe 20-21

Kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe, Dr. Argëtim Fida me komunitetin dibran në New York

Që t'ia kthejmë shpresën Dibrës e ta çojmë aty ku e meriton



faqe 14-15

Monumenti i Lotit

Nga cikli i udhëtimeve nëpër vendbanimet e arbëreshëve



faqe 37-38

Fitore e PDK-së në Prizren dhe Lipjan

LDK në konfuzion, elektorati e ndëshkon

faqe 17

Kroatët dhe shqiptarët më së paku i besojnë Serbisë

faqe 19

Kastriot Islami: Jemi socialistë më shumë se Edi Rama



faqe 12

Sa do të kushtojë humbja e karrikes së Ted Kennedy-t në Senat?



faqe 10

Pages in English 2-8

Albania and Greece hunt murder suspect

page 3

Kosova's New Highway – 'The Most Expensive in Region'

page 3

Madeleine Albright returns to Wellesley

page 7

British geographers find uncharted glaciers in Albania

page 8

NGA CIKLI I UDHËTIMEVE NËPËR VENDBANIMET E ARBËRESHËVE

Monumenti i Lotit

Nga Ylli Polovina

Çfarë ishte ajo sferë përballë të cilës ndalëm këmbët? I ndalëm apo në të vërtetë ato papritur na u mpinë? Ai rruzull gjysmë i mbështjellë me gurë si me një lëvozhgë ngjyrë artë herë na dukej si fryt i prodhuar nga pemë kozmike të rritura në yllësinë e pafund të qiellit dhe herë si një lloj meteori, që pasi ishte shkëputur prej galaktikash të largëta, i përvëlur nga flakët, pati rënë megjithatë i paprishur, si një mesazh hyjnor, në tokat ku prej shekujsh mërgonin arbëreshët.

Si të shushatur bëmë disa hapa përreth sferës, në mundim të plotë për ta kuptuar atë krijesë. Diku duhej të qe titulli i asaj vepre artistike ose të paktën emri i autorit. Më në fund e gjetëm një shenjë prej ku diçka mund të fthonim. Ishte një pllakëzë e shkruar në dy gjuhë, arbërisht dhe italisht.

Qenë vendosur në të vargjet e këngës së njohur, himnit të arbëreshëve, "Moj e bukura Morë".

Vargjet i lexojmë duke mos mundur dot ta përmbajmë e qetësojmë veten. Për të gjithë ata shqiptarë që e kanë dëgjuar atë melodi e njihet mirë se si, ndërsa trupin ta rëmbushin mornicat, ndihesh e bëhesh menjëherë arbëresh.

Moj e bukura Morë,
Si të lë u më nëng të pe si të le.
Si të le, si të le u më nëng të pe
Atje ku kam u zotin Tatë,
Atje ku kam zonjin Mëmë
Atje kam edhe t'im vëlla gjithë
mbuluar,
Gjithë mbuluar, gjithë mbuluar
nën atë dhe,
Moj e bukura Morë.

Vështirë në botë të gjenden shumë krijime të tilla. Duhet të jenë mjaft të pakta. Melodia dhe teksti i saj për nivelin artistik dhe për forcën e dramës që ngërthejnë janë shekspiriane. Nuk mund të shpjgohet ndryshe veç prej këtij gjenialiteti jo vetëm mbijetesa qindra vjeçare, mosvshkja e saj, mos harrimi, por edhe freskia si të jetë krijuar ato caste kur e këndon. "Moj e bukura Morë" është e interpretueshme po aq magjishëm me zë njeriu dhe vetëm melodi, në kor dhe fillikat, në muzgun e ditës dhe kur sapo zbardh agimi, kur të mbulojnë ëndrrat dhe kur dëshiron vetëm të mendosh, kur je femijë apo në fund të jetës, ndërsa je vajzë e re dhe kur ndihesh nënë. Jo, nuk mund të shpjgohet ky mbijetim shekullor përveç me nivelin e jashtëzakonshëm artistik

të kësaj kënge. Po të kishte ajo një emër autori ai do të qe mbuluar i tëri nga lavdia dhe në trojet e shqiptarëve, madje kudo në glob ku ata kanë ngritur familjet e tyre, sheshet, rrugët e parqet do të mbuloreshin nga bustet e tij. Në mungesë të këtij emri njeriu konkret (i cili në anonimat e vet doemos ka ekzistuar), "Moj e bukura Morë" ka autor vetë Arbërinë.

Ajo është KËNGË KOMBI.

Është monumenti i tij.

Këtë duket se e di edhe krijuesi i asaj sferë të artë në Shën Sofi, rruzull që tani na duket se është i mbushur me lot. Thua këtu në shekuj të shekujve, madje deri një ditë më parë, në mos vetëm pak minuta para se atij mëngjesi të vinim ne, aty arbëreshët me mijëra qenë mbledhur e patën lotuar.

Ah, lotët e mërgimtarëve! Janë më të dhimbshmit në botë, të nxehet gjer në përvëlím. Jemi vendi ku në një qytet të tërë të madhërisëm dhe gjithë kulturë, në Korçë, njëra lëndinë e saj mban emrin e lotëve.

Mbijetimi qindravjeçar i "Moj e bukura Morë" e ka të fshehtë tek malli i përhershëm i arbëreshëve për Shqipërinë, gati një ethe që nuk u fashit dhe nuk u shërua kurrë, një temperaturë e dhimbje e brendshme e vazhduar, shpesh aq munduese sa u ka shkaktuar zhgjiëndrra, u ka sjellë pamje jo reale, vegime. Ka ndodhur një gjë e tillë edhe me kryekëngën e tyre të mërgimit.

Në pamje të parë ngjan me një absurd, me një gjë të papërfytyrueshme prej një logjike të ftohtë. Moreja nuk është tokë shqiptare, historikisht e tërësisht është greke. Është Peloponezi i sotëm. Në mjaft qytete dhe kështjella të këtij gadishulli të zotëruara nga Republika e Venedikut shqiptarët qenë punësuar si luftëtarë (stratiotë). Edhe pse pas pushtimit osman një pjesë e tyre migruan në tokën italiane atë melodi dhimbjeje e këndojnë duke pasur ndër mend dhe në zemër vetëm Shqipërinë, asnjë truall tjetër.

Edhe pse saktësisht me rënie dhe pushtimin e qytetit Korona, kështjellë në Peloponez, shumë arbëer dhe grekë u zhvendosën në Italinë e Jugut, këtu fshatrat arbëreshë rezistuan fort, kurse ata helenë e patën shumë të vështirë mbijetimin. U rralluan. "Moj e bukura Morë" patjetër është kënduar nga të dy etnitë, madje ajo i ka mbajtur të afërt njëri me tjetrin, pothuaj të bashkuar. Megjithatë në fund të fundit atë këngë të rrallë, atë thesar historie dhe iden-



Pamje nga monumenti "Shqiptarët e Italisë".

titeti, e ruajtën dhe e mbajtën gjallë arbëreshët. Madje ajo kishte nisur të harrohej kur vargjet ia gjeti një studiues shqiptar, Nikollë Filja (1682-1769). Vendi ku u zbulua ishte qyteza arbëreshe Qeft (italisht Chieuti), krahina Molise. Ndodhej në një dorëshkrim prej 105 faqesh, ku pranë njëra-tjetrës qenë një doktrinë e krishterë, disa poezi laike dhe një përmbledhje këngësh popullore. Ishte një manifest arbëror lirie mendimi, pluralizmi të vërtetë.

E veçanta, por edhe befasuesja, qe se arbëreshi Filja këngën "Moj e bukura Morë" e gjeti në gjuhën shqipe, por të shkruar me alfabet grek. Rrinin bashkë e të pandarë të dy popujt.

Me siguri bashkëkombësit tanë të vjetër e kanë kryer këtë vepër kujtese historike edhe në mbrojtje e respekt të thellë të grekëve. Me ta kishin jetuar në Ballkan, por edhe në viset e reja të mërgimit. Ndihehin dhe qenë miq, shokë fati të njëjtë. Arbëreshët jetën e tyre prej më shumë se pesë shekujsh e kaluan në një tokë e vend tjetër dhe nuk përjetuan gjysmën e dytë të shekullit në nëntëmbëdhjetë, kur helenët krijuan shtetin e vet dhe në kundërshtim me frytin e bukur të miqësisë e vëllazërimit që dy popujve u kishte dhënë historia, i zgjeruan kufijtë e tij, nën një absurd shoven në kuriz të miqve të tyre të sinqertë, shqiptarëve.

Arbëreshët këto gjëra të mbrapshta nuk i kanë përjetuar. Disa të paktë i dinë vetëm prej leximit të librave të historisë. Në Shën Sofi në mbresë të vëllazërisë së shekujve të shkruar njëra nga rrugët siç quhet Via Epiro, tjetra, një lloj shëtitoreje, ka emrin e Marko Bocarit (Largo Mrco Botsaris).

Emërtimi Santa Sofia degli Albanesi është gjetur i dokumentuar që në vitin 1571, kurse tani Shën Sofia ka shtesë fjalën Epiro. Ngjarja ka ndodhur në vitin 1873, me një vendim mbretëror të Romës.

Atëherë u justifikua si një mënyrë për t'u dalluar nga një Santa Sofia e gjendur në krahinën veriore të Romanjës.

Sigurisht është një gjest tërësisht e kryer nën logjikën e asaj kohe kur shteti i pavarur grek, i shkëputur më në fund nga sundimi osman, po e vinte në jetë projektin e tij të ekspansionit territorial mbi shpërfilljen ndaj shqiptarëve.

Në Shën Sofi, mbase duke ditur se edhe mjaft qyteza të tjera arbëreshe afër apo disi më larg, e kanë përcaktorin Albanesi, nuk kanë ngulur këmbë për t'u rikthyer në emrin e tyre historik. Ka të ngjarë që gjenden mirë me emrin e njëqind e pesëdhjetë viteve të fundit, sepse ruajnë të palëkundur respektin e tyre për popullin grek, me të cilin një pjesë e paraardhësve të tyre jetuan në Peloponez dhe së bashku më pas migruan.

Porse në Siçili vendbanimit të madh deri një shekull më parë thirrur Piana degli Greci (Hora e Grekëve), arbëreshët me kohë e kanë bërë Piana degli Albanesi (Hora e Shqiptarëve). Dhe jo vetëm këtu.

Por as "E bukura Morë" nuk u bë kurrë "E bukura Arbëri".

Për shumë arsye. Shumë bashkëkombës, arvanitasit e sotëm, do të ndiheshin të përjash-tuar padrejtësisht nga ajo që kanë pasur imazh të gjithë paraardhësit tanë të pesë-gjashtë qind viteve më parë. Kur arbëreshët lanë brigjet e përtej dy detrave, Adriatik dhe Jon, ata jetonin nëpër të gjithë bregun, gjer në buzë të Egjeut. Atëherë në ndërgjegje e tyre, ndryshe nga tani, nuk vepronin konceptet e sotme për shtetet dhe kombet. Këto atë kohë qenë vagël-lim politik e social. Popujt i kishin tokat e shtëpitë e tyre, trojet ku patën lindur dhe vdekur, pa kufij. Një arbëresh mund të jetonte normalisht në Greqi nën një sundimtar helen po aq natyrshëm sa edhe një grek nën një feudal shqiptar. Arbëri ishte e gjithë hapësira

përtej detit, i gjithë horizonti. Arbëri qe po aq Moreja sa edhe vetë qielli në sfond të ujërave të kaltra, madje edhe vetë deti.

Malli i mërgimtarit, duke qenë vuajtje, nuk ka kufi, nuk dëshiron asnjë kufi. Është planetar.

Në Arbëri akoma ka qyteza ku bashkëkombësit tanë në një ditë të vitit, në pranverë, më shpesh ditë pashke, prill apo maj, kthehen me fytyrë nga deti dhe për një kohë shohin në lindje. Është çasti kur zemra u vrapon larg, në mëmëdhe dhe vetëm trupi u rri në tokën italiane. Është momenti më i brishtë i jetës, në duket shpesh se ato caste po t'i prekësh pak, vetëm me një gisht, do t'ua prishësh atë magji. Arbëreshët me atë vështrim të ngulitur në horizontin e mbi ujërave të detit marrin energji mbi-jetimi sa për të gjithë vitin. E kanë fat atë afërsi të tokës amë, por edhe vuajtje.

Ata e dëshirojnë të pakëputur këtë lidhje. E duan të tillë sepse pas çastit të parë të mërgimit për breza e breza të tërë nuk e larguan nga ëndrrat e tyre mundësinë e rikthimit në atdhe. Ai moment i vendosjes së fytyrës së tyre nga deti nuk është gjë tjetër veç kjo dëshirë shekullore për t'u rikthyer. Nuk mundën dot të shkonin fizikisht, atëherë si eter dërgojnë atje shpirtin.

Ishte një pritje e gjatë ajo e arbëreshëve në tokën italiane, përherë me shpresë se do të rilindte një Skënderbe tjetër dhe do t'i çlironte tokat e pushtuara nga turqit. Oh, sa e kanë pritur Skënderbeun e dytë!

Pastaj ai, Skënderbeu i Dytë, për në vendin tashmë të lirë do t'i ftonte ata dhjetëra e dhjetëra mijëra mërgimtarë arbërorë t'u rihipnin anijeve dhe ktheheshin në shtëpitë e tyre!

Ja përse kënga për të bukurën Morë që në vargun e parë thotë "Si të lash e më s'të pash". Ja përse pastaj përsërit me dhimbje sflitëse

